Numër: 01/43
Datë: 22.02.2022

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ për Njohjen e Mësimit Paraprak (UA Nr. 31/2014, date 05.09.2014), dhe Udhëzimit Administrativ për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë (UA Nr. 09/2019, datë 18.06.2019), Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 22.02.2022 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet** institucioni "Qendra e Trajnimit – Korporata Energjetike e Kosovës", me adresë: Rr. "Vëllezërit Gërvalla", 15000 OBILIQ, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 22.02.2022 deri më 21.02.2025, për zbatimin e Njohjes së mësimit Paraprak (NjMP), me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).
   - **1.1 Instalues Elektrik,** Niveli IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 10 kredi të AAP. IAAP mund të përfshij në procesin e NjMP deri në 7 kandidat brenda muajit, dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në njëmbdhjet (11) grupe.

1. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit "Qendra e Trajnimit – Korporata Energjetike e Kosovës", për akreditim të zbatimit të NjMP dhe rekomandimeve të dala nga Raporti vlerësues i ekipit të ekspertëve për akreditimin e institucioneve që zbatojnë Njohjes e Mësimit Paraprak (NjMP), u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për Akreditim

të zbatimit të NjMP si institucion, Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë (UA Nr.09/2019, i datës 18.06.2019). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit "Qendra e Trajnimit - Korporata Energjetike e Kosovës", dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK